

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 7808 Rep.
Nr. 1331 Kol. 14



AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
"SHKOZA PARK" Sh.p.k.

Sot me 22.06., 2007, para meje Noterit te Dhomës se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht:

- **Z. Andi Memi**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 03.04.1979, mbajtës i pasaportës me nr. Z1568283;
- **Z. Ilir Bejleri**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 05.04.1978, mbajtës i pasaportës me nr. Z1669081
- **Z. Devis Bano**, shtetas shqiptar, lindur ne Berat, me 21.08.1977, mbajtës i pasaportës me nr. 1550893;

Te gjithë persona madhore e me zotësi te plote për te vepruar, për identitetin e te cilëve u binda nga dokumentet qe me paraqiten.

Ata me vullnetin e tyre te plote e te lire, nënshkruan ne prezencën time këtë Akt Themelimi te shoqërisë Shkoza Park Shpk (me poshtë "*Shoqëria*").

I.

Krijimi

Shoqëria me Përgjegjësi te Kufizuar "Shkoza Park" Sh.p.k., krijohet dhe do te ushtroje aktivitetin e saj sipas legjislacionit te Republikës se Shqipërisë.

II.

Ortaket Themelues dhe Kapitali

Shoqëria krijohet nga personat emrat dhe gjeneralitetet e te cilëve janë përshkruar me sipër ne këtë akt.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mije) Leke dhe është i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1.000 (njëmijë) Leke secila. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet dhe derdhet tërësisht ne te holla nga Ortaket si me poshtë:

Andi Memi
Ilir Bejleri
Devis Bano

34 kuota, e barabarte me 34% e kapitalit;
33 kuota, e barabarte me 33% e kapitalit;
33 kuota, e barabarte me 33% e kapitalit;

III.

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. Nikolla Tupe, nr. 5 kati I, Tirane, Shqipëri. Shoqëria mund te nape dege dhe/ose te krijojë filiale, si dhe te kryejë aktivitetin e saj si brenda, ashtu edhe jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë.

IV.

Objekti

Shoqëria ka për objekt te kryejë dhe te marre pjese ne te gjitha aktivitetet dhe bizneset qe një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te kryejë ne baze te legjislacionit shqiptar, dhe veçanërisht do te kryejë aktivitetin e saj ne këto fusha:

- Përgatitje projektesh investimi ne te gjitha fushat e tregtisë dhe industrisë për llogari te vet ose te porositësve te trete;
- Investime ne zhvillimin e pasurive te paluajtshme;
- Krijim i partneriteteve me subjekte te treta për realizimin dhe financimin e projekteve te investimit ne tregti, industri ose ndërtim;
- Financim, ndërtim dhe menaxhim te objekteve te ndryshme civile dhe industriale;
- Projektim, Zbatim dhe Mbikëqyrje punime ndërtimi si dhe punime te tjera ndërtimi ne shtrim asfaltim rrugësh, autostrada dhe vepra te tjera publike;
- Import-Eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te materialeve te ndërtimit si dhe import-eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore, industriale dhe veshmbathjeve;
- Menaxhim Bar-Kafe, Restorante, Kinema, Hotele, Qendra Biznesi apo objekte industriale si dhe aktivitete te tjera ndihmese;
- Ndërmjetësim ne shitje dhe blerje pasurish te paluajtshme;
- Si dhe çdo aktivitet tjetër te nevojshëm për përmbushjen e sa me sipër.


Shoqëria mund te blejë e te shesë pasuri te paluajtshme apo te luajtshme, te marre kredi ne banka për realizimin e projekteve dhe investimeve te saj, përfshirë edhe mundësia për te dhëne garanci (peng, hipoteke, barre siguruese), dhe ne përgjithësi te ushtroje çdo aktivitet te nevojshëm për realizimin e objektit te saj.

Shoqëria mund te blejë e te shesë kuota ose aksione ne shoqëri te treta, si ne mënyrë te drejtpërdrejtë ashtu edhe nëpërmjet shoqërive te kontrolluara prej saj si dhe te marre pjese ne konsorciume te ndryshme me shoqëri te tjera për realizimin e aktiviteteve te përbashkëta.

V.

Administratori

Shoqëria do te administrohet nga Administratori i vetëm Z. Andi Memi. Nëpërmjet këtij Akti Themelimi, Administrator i Shoqërisë emërohet Z. Andi Memi, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës me nr. Z1568283, banues ne adresën Rr. Dora D'Istria, Pall. 10, Ap. 21, Tirane.



VI.
Përgjegjësia Personale

Ortakët janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve deri në vlerën e kuotës së investuar në kapitalin themeltar.

VII.
Norma te Organizimit

Normat për organizimin, rregullat dhe drejtimi e administrimi i aktivitetit të Shoqërisë dhe çështjeve të saj të brendshme, janë parashikuar në Statutin bashkëngjitur, i cili mund të modifikohet me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

VIII.
Fillimi i Aktivitetit


Shoqëria, nuk do të fillojë aktivitetin e saj pa depozituar të paktën 100.000 (njëqind mijë) Leke në të holla si kapital themeltar i shoqërisë.

NE PRANI TE NJERI TJETRIT, në nënshkruajmë me vullnetin tone të lire e të plote këtë Akt Themelimi, sot me datë __. __. 2007.


Unë Noteri lexoj me zë të lartë tekstin e këtij dokumenti. Palët njihen me përmbajtjen e tij, dhe pasi e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të plote e të lire, e nënshkruajnë rregullisht në praninë time dhe unë Noteri vërtetoj këtë dokument sipas ligjit.

ORTAKET:


Z. Andi Memi




Z. Ilir Bejlari




Z. Devis Bano



NOTERI





AKTI I THEMELIMIT
(I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR)

Duke u bazuar në Ligjin Nr.7512,datë 10.08.1991 "Për sanksionimin e mbrojtjen e pronës private,të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" ; në ligjin Nr. 7632,datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar"; Ligjin Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare"; si dhe në ligjin Nr.7667, datë 28.1.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",unë **LORENCA TOSKA** e bija e Jakë-s dhe i Marija-s e dtl 13.10.1967 lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë Rruga Gjon Buzuku, Lagja Nr.3, Nr 77; me vullnetin tim të lirë të cilin e shpreh dhe në nënshkrimin e këtij akti, THEMELOJ shoqërinë "**ITALMEDICA 1**" sh.p.k.

LLOJI I SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të jetë "Shoqëri Tregtare" e formës "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

EMËRTIMI TREGTAR

Kjo shoqëri do të quhet "**ITALMEDICA 1**" sh.p.k.

KOHEZGJATJA

Kohzëgjatja e kësaj shoqërie do të jetë pa afat , duke filluar nga data e rregjistrimit të shoqërisë në regjistrin Tregtar, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligji ose me vendim të ortakut të vetëm .

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të jetë :

- Hapja dhe menaxhimi i një laborator për të gjitha llojet e analizave klinike e baktoreologjike, dozat radioimnologue,toksikologjia,sieroimnولوجjia,citoistopatologjia, gjenetica,hematologjia dhe virologjia, analiza e ujërave dhe të gjitha prodhimeve biologjike, analiza e tokës dhe atmosferës,qendër për diagnostikime klinike të përgjithëshme dhe speciale dhe terapi e specialiteteve të mëposhtme:
radiologji, rezonancë magnetike bërthamore, TAC, ekografi, ekografi interniste, ekografi gjinekologjike, ekografi urologjike , mjekësi bërthamore in vivo dhe in vitro, SPECT,PET, terapi bombarduese me izotope radioaktive, kobalto-terapi, përshpejtim linear, alergologji, bronkopneumologji, aerosol-terapi, kardiologji, elektrokardiografi, angiologji,ekokardiografi, doppler,Kolor-doppler,hemodializë,nefrologji,obstetrike-gjinekologji,pediatria,otorino, urologjia,gastroenterologjia, ortopedia, reumatologjia, okulistika,odontoiatra, psikiatria, psikologjia, etj
- trajtim për heqjen e duhanit
- Trajtim i patologjive psikiatrike me instrumenta të ë vecanta
- Kirurgjia e përgjithëshme dhe ambulatoriale

Lorenca Toska

- Blerje dhe administrim i klinikave private dhe spitaleve jo-publike
- Veterinari
- Depo farmaceutike për tregtim me shumicë dhe pakicë ,import-eksport të barnave dhe ilaçeve .
- Tregtim me shumicë dhe pakicë i artikujve sanitare, parfumeri,
- Prodhim dhe tregtim i bimëve mjekësore

Përveç kësaj shoqëria mund të ushtroj edhe aktivitet

- për të gjitha llojet e projekteve dhe punimeve të ndërtimit të parashikuara për tu licencuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit(Emërtimi i Ministrisë varion sipas ndryshimeve që pëson më vonë).

Shërbime të konsulencës inxhinierike në fushën e :

- Mbikqyrjes së zbatimit të punimeve ,
- Kolaudimit të zbatimit të punimeve

- Pastrim i mbeturinave inerte urbane dhe i plehrave të qytetit
- Ngritja e fidanishteve dhe serave të luleve, për prodhimin dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë, import export i frutave të njoma, e të thata, pemëve frutore, dekorative dhe ambalazhim i tyre,
- Prodhim i konfeksioneve të ndryshme të gatëshme dhe gjysëm të gatëshme, blerjen e lëndës së tyre të parë, ndihmëse, si dhe teknologji dhe pajisje si dhe ambalazhimi dhe stampimi i tyre .
- Hapje agjensi turistike udhëtimi për kryerjen e shërbimeve dhe udhëtimeve turistike me turistë të huaj dhe vendas, individ ose në grupe,
- Agjensi e transportit turistik
- Shitja e biletave të transportit ajror , detar e tokësor.
- Vënia në dispozicion me qera pjesore dhe totale e mjeteve të transportit turistik.
- Tregtimi dhe prodhimi i materialeve të ndërtimit(inerte, çimento, llaç, gelqere, pllaka, tjegulla, tulla, blloqe, skele, armatura e gjithshka lidhet me ndërtimin
- Tregtim me shumicë dhe pakicë import eksport i duraluminit, dhe produkteve të gatëshme apo gjysëm të gatëshme të duraluminit, produkteve dhe nënprodukteve bujqësore dhe blegtorale, përpunim dhe ambalazhim i tyre, ushqimeve për blegtorinë, farërave ,fidaneve, plehra kimike, makineri bujqësore e blegtorale , bimë medicinale.
- Prodhim dhe tregtim i lëkurëve e prodhimeve të tjera si canta ,këpucë etj.
- Prodhim e tregtim e ambalazhim i mishit dhe formave të ndryshme të përpunimit të tij.
- Tregtim me shumicë dhe pakicë import eksport i artikujve të ndryshëm industrial(kancelari dhe artikuj shkollor etj) ,i artikujve ushqimor, hidrosanitare, goma makinash, elektroshtëpiake, elektrike, tekstile, makineri e pajisje. Hapje rrobaqepësie .
- Tregtim me pakicë import eksport i hidrokarbureve, karburanteve dhe gazit natyror për ngrohje , gatim dhe lëndë djegëse për automjetet si dhe të gazit të lëngët. Hapje pikë karburanti me pakicë (stacion distributor). Bar kafe.
- E drejta për të bërë të gjitha llojet e punimeve, studimeve, projekteve dhe investimeve në mjedis, turizëm dhe pyje..Mbarështim i pyjeve , prerja ,përpunimi dhe tregtim me shumicë dhe pakicë import eksport i lëndës drusore.
- Tregtim i pjesëve të këmbimit për autovetura, mjete transporti, tapiceri, atreçature etj.
- Shfrytëzim terrenesh sportive sic janë fushat për ushtrimin e sporteve të ndryshme, ngritje dhe shfrytëzim palestrash etj.Salla lojrash për fëmijë
- Ngritjen e qendrave të informimit dhe shërbimit për turizëm, mjedis
- Shoqëria do të ketë mundësi, gjithashtu, të kryejë të gjitha operacionet tregëtare, ekonomike, industriale, në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe financiare që kanë lidhje të ngushtë me objektin shoqëror dhe të nevojshme ose të dobishme për pëmbushjen e këtij objekti, në mënyrë që të përputhen me objektin e aktivitetit duke përfshirë këtu edhe pjesmarrjen e shoqërisë në shoqëri me objekt të njëjtë ose të përafërt.

SELIA E SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të ketë selinë e vet Rruga "Qemal Stafa" ,Përballë Prokurorisë së Përgjithëshme Tiranë.

Lorenca Toska

KAPITALI THEMELTAR

Shuma e kapitalit themeltar të kësaj shoqërie është 100.000 (një qind mijë lekë të reja). Ortaku i vetëm zotëron 100 % të kuotave të shoqërisë.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Kjo shoqëri administrohet nga administrator znj. **LORENCA TOSKA** e cila është dhe ortaku i vetëm i kësaj shoqërie. Kompetencat e përfaqësimit të administratorit parashikohen në statut .

THEMELUESI
LORENCA TOSKA


Lorenca Toska

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr i rep 1005
Nr i kol ✓

AUTENTIFIKIM NËNSHKRIMI

Sot me datë 27.06.2007 përpara meje noteres Elvira G. Alibali u paraqit personalisht administratorja e shoqërisë "ITALMEDICA 1" sh.p.k , **LORENCA TOSKA** e bija e Jakës dhe i Marija-s e dtl 13.10.1967 lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë Rruga Gjon Buzuku Lagja Nr.3 Nr.77 , Per identitetin e të cilës u sigurova në bazë të certifikatës me fotografi N. 2/79 dhe si konstatova se i ka të gjitha aftësitë e kërkuara nga ligja i vërtetova sa më sipër rezulton nënshkrimin e saj.



NOTERE
ELVIRA G. ALIBALI

